



Skudra kukesiane ka marre nje fitore me shume rendesi, ne transferten e veshtire te Krujes, ndaj Kastriotit vendas. Ka qene nje ndeshje me nivel mesatar, ku loja është përëndruar me teper ne sektorët e mesfushës. Goli i vetëm i ndeshjes ka ardhur në dhjete minutëshin e fundit të ndeshjes, me autor kryeqyetasin Allmuca i cili ka ditur te finalizoj me sukses nje pasim te saktë të Cikalleshit në krahun e djathte te sulmit. Vëndasit kanë patur dy tre mundesi për të shënuar por mbrojtja mike ka qenë në lartësinë e duhur. Fitorja e arritur, është konsideruar mjaft e rëndësishme për drejtuesit kukesian, të cilët janë optimist, për te ardhmen e skuadres se tyre, duke filluar te mendojne per ndeshjen e radhës që do ta luajnë po në fushë asnjane. Trajneri kukesian Cungu pavarësisht fitores nuk ishte i kënaqur me lojën e skuadrës së tyre. Kukesi javën e ardhëshme do të ndeshet me Partizanin. Ndeshja e sotme u ndoq nga nje numër i pakët sportdashësish